

Kur ju merrni një vendim pozitiv për kërkesën tuaj për azil

Pasi të keni marrë një vendim pozitiv për kërkesën tuaj për azil, ne e dimë se ndoshta do të keni shumë gjëra për të menduar. Këto mund të përfshijnë planet tuaja për të studiuar, për të punuar ose për të udhëtuar për të takuar njerëzit tuaj të dashur. **Pasi të keni marrë vendimin, keni vetëm një kohë të shkurtër përpara se të përfundojë mbështetja juaj nga azili, kështu që është e rëndësishme që së pari të përqendroheni në këto tre gjëra.**

1. Dëshmia e statusit dhe identifikimit - Leje Rezidence Biometrike (BRP)

- Pasi të keni marrë një vendim pozitiv, Home Office duhet t'ju dërgojë juve ose avokatit tuaj një kartë BRP (Leje Rezidence Biometrike. Mund të vijë me email ose me poste. Duhet ta merrni të paktën 7 ditë përpara datës që do t'ju duhet të largoheni nga akomodimi juaj.
- Karta BRP – Leja e Rezidences Biometrike është dokumenti juaj i ri i identifikimit (ID) dhe është shumë i rëndësishëm. Do t'ju duhet për të gjetur një punë ose për të kërkuar ndihma dhe për të marrë me qira një vend për të jetuar.
- Nëse nuk ju ka ardhur karta BRP (Leja e Rezidences Biometrike) dhe mbështetja juaj përfundon për 7 ditë ose më pak, ju lutemi kontaktoni urgjentisht Migrant Help në 0808 8010 503 ose me email në positivemoveon@migranthelpuk.org.

2. Paratë tuaja

- Pasi të keni marrë një vendim pozitiv, ju lejohet të punoni dhe të fitoni para.
- nuk mund të punoni ose nuk mund të gjeni një punë shpejt, duhet të aplikoni për ndihma sociale (zakonisht Universal Credit). Mund të aplikoni online ose personalisht në qendrën tuaj më të afërt të Job Centre Plus.
- Bëjeni këtë menjëherë pasi mund të duhet pak kohë përpara se të merrni pagesat tuaja.
- Nëse nuk e keni kartën BRP (Lejen e Rezidences Biometrike), mund të përdorni letrën tuaj të Grantit të Azilit dhe kartën ARC për të aplikuar për ndihma sociale.
- Do t'ju duhet gjithashtu të hapni një llogari bankare.

3. Strehimi juaj

- Pasi të keni një vendim pozitiv, mund të filloni të kërkonte dhe të zhvendoseni në banesën tuaj.
- Mund t'i kërkonte Bashkisë tuaj lokale (aty ku jetoni kur merrni vendimin tuaj) t'ju ndihmojë. Nëse në përgjithësi jeni të shëndetshëm dhe nëse nuk keni fëmijë që jetojnë me ju, nuk do të shihen si prioritet dhe nuk ka gjasa t'ju ofrojnë ndonjë strehim. Për momentin ka një mungesë të madhe të banesave sociale dhe akomodimit bashkiak për të gjithë njerëzit.

Strehimi ABC

A Së pari – **pranoni** që vendi i parë që gjeni mund të jetë vetëm afatshkurtër. Mund të jetë strehim i vogël, i përbashkët ose i përkohshëm dhe jo në zonën ku dëshironi të jetoni.

B Së dyti – pasi të keni disa të ardhura dhe/ose një punë, mund të kërkonte një vend **më të mirë** për të marrë me qira që është më afër asaj që dëshironi, por gjithsesi i përballeshëm. Gjëra të tilla si klasa për mësimin e anglishtes dhe mbështetja e punësimit do t'ju ndihmojnë ta bëni këtë.

C Më vonë – punoni për të shkuar drejt një shtëpie të **rehatshme** ku dëshironi të jetoni për një afat më të gjatë.

